

#00005

INSTITUTI I STATISTIKAVE



## Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë punonjës me kontratë pune në pozicionet: 50 ANKETUES TERRENI në kuadër të Projektit Pilot të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020

### TITULLI I SHPALLJES 50 ANKETUES TERRENI NË KUADËR TË PROJEKTIT PILOT TË CENSIT TË POPULLSISË DHE BANESAVE 2020

#### Termet e referencës:

- Anketuesi është personi përgjegjës për mbledhjen e informacionit sipas pyetsorit të ingranuar në tablet, sipas udhëzimeve të përgatitura nga specialistët përkatës të INSTAT-it dhe rekomandimeve ndërkombëtare;
- Viziton të gjitha banesat dhe NjEF të cilat duhet të intervistohen, bazuar në hartën e ZC tuaj dhe në planin që ju keni bërë.
- Detyra kryesore e anketuesit në census është numërimi me cilësi i të gjithë NjEF-ve brenda zonës tuaj (ZC) dhe përfundimi i regjistrimit të tyre brenda afateve të caktuara.
- Merr përsipër të gjithë detyrat nga kontrollori ose nga Zyra Rajonale e Censurit dhe raporton për ecurinë e punës.
- Raportoni çdo ditë me telefon celular me kartën e dhënë nga INSTAT-i për numrin e banesave, NjEF-ve dhe personave që keni numëruar një ditë më parë, si dhe numrin e refuzimeve të një dite më parë.
- Anketuesi është i detyruar të ndjekë me përgjegjësi trajnimin, që do të organizohet nga stafi i INSTAT si dhe të studiojë udhërrëfyesin përpara se të shkojë në terren;
- Anketuesi duhet të ketë paraqitje serioze në punë, të sillet në mënyrë korrekte, të jetë i komunikueshëm dhe këmbëngulës për të marrë informacionin e kërkuar;
- Bazuar në Ligjin Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", anketuesi duhet të respektojë rregullat e konfidencialitetit;

#### Kriteret e përzgjedhjes:

Kriteret për rekrutimin e anketuesve, janë:

- Të kenë diplomën e shkollës së mesme (arsimi i lartë përbën avantazh)
- Të jenë banorë rezidentë në Bashkinë përkatëse;
- Preferohen të jenë të moshës nga 21 deri në 60 vjec;
- Të jenë të aftë të lëvizin në distancë të largëta;
- Të zotërojnë aftësitë mira komunikuese;
- Të jenë të familjarizuar në përdorimin e mjeteve komunikuese, (kompjuter tablet);

- Të jenë të gatshëm për ndjekjen e punës në terren
- Të jenë të papunë;
- Personat me eksperiencë të mëparshme në vrojtime përbëjnë avantazh

**Informacione të tjera:**Sqarim:

TE GJITHE APLIKANTET, NE CV-NE E TYRE, TE SPECIFIKOJNE NJESINE ADMINISTRATIVE PER TE CILEN KERKOJNE TE PUNOJNE, SIPAS TABELES SE SHPERNDARJES TE CILEN E GJENI BASHKELIDHUR KETIJ NJOFTIMI

**Material plotësues**

Pershkrimi i punes dhe tabela e shperndarjes: ([http://instat.gov.al/media/6068/anketues-terreni-\\_pershkrimi-punes-dhe-tabela-e-shperndarjes.pdf](http://instat.gov.al/media/6068/anketues-terreni-_pershkrimi-punes-dhe-tabela-e-shperndarjes.pdf))

**Afati i aplikimit:**7/31/2019

Aplikimi realizohet nëpërmjet faqes së Institutit të Statistikave në seksionin e vëndeve vakante për pozicionet me kontrata të përkohëshme.

**Ju duhet të hyni / rregjistroheni më parë në sistem për të aplikuar për këtë pozicion pune (<http://rekrutime.instat.gov.al/aplikant>)**